



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Pranimë / Date: 27-03-2025			
Nr. Llogarit Org. Breg	Nr. Breg	Nr. Llogarit Org. Breg	Vlera Vlerësim
01-	110/05-	264	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), lidhur me neni 6, paragrafi 1, pika 1.1, neni 8, paragrafi 1, pika 1.1 lidhur me neni 14 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr. 10, prill 2019), neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.03.2025 miraton këtë:

V E N D I M

paraparak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik si në vijim:

1. Pjesën prej 300 m² të Njesisë Kadastrale P-70101005-00630-0, nga sipërfaqe e përgjithshme prej 13282 m², toka bujqësore, kullosë e klasit të 5-të, në vendin e quajtur "Zabel", në zonën kadastrale në Terpezë, e cila evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është afatshkurtër, me kohëzgjatje prej 15 viteve, me destinim kulturorë bujqësore, me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është interesi publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 4

Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohen përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të kryetarit të komunës dhe përfituesit të marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit, me të drejtë të shkëputjes së kontratës edhe para afatit, nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Drejtoria për Financa e Komunës së Vitisë.

Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NUMËRIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101005-00630-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

17/7/2025
11.02.2025 - 11:03
VITI / VITINA / VITI

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:


Tërpezë / Tripeza / Tërpezë
VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101005-00630-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		13282			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ZABEL				





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Tërpezë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101005-00630-0	Parcelë / Parcela / Parcel	13282



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1969